

Për:	Operatori Ekonomik: MAZREKU SH.P.K., Gurqi, 24000, Malisheve Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	08.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **07.06.2022**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MAZREKU SH.P.K.** me adresë në **Malisheve**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-4060-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-22-014-1-3-6**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MAZREKU SH.P.K.** me adresë në **Malisheve**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-4060-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-22-014-1-3-6**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **03.06.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-4060-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-22-014-1-3-6**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: MAZREKU SH.P.K. me adresë në Malisheve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: FURNIZIM ME KËNDIN E LODRAVE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE "TULIPANËT" NË RAHOVEC, me Numër të prokurimit: 623-22-4060-1-3-6, Numër i brendshëm: 623-22-014-1-3-6, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 03.06.2022, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 07.06.2022, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

-AK KOMUNA E RAHOVECIT, me datë 03.06.2022 ka publikuar vendimin e AK për këtë procedurë duke e propozuar për kontratë OE MILAZIM BALA B.I.

Vlera e parashikuar për këtë procedurë në bazë të dosjes së tenderit është: 5000 euro.

Ne kemi ofertuar me çmimin prej: 4,425.00 euro.

AK ka shpërblyer OE i cili ka ofertën prej: 8000 euro !!! (60% mbi vlerën e parashikuar dhe 80.79% mbi vlerën e ofertës sonë).

Nisur nga ky fakt ne konsiderojmë se zyrtarët e AK na kanë eliminuar me qëllim për të përfituar për vete dhe të tjerët në mënyrë të kundërligjshme.

Edhe vërtet sikur ne të ishim OE i pa përgjegjshëm, AK do të duhej të anulonte këtë procedurë për shkak të tejkalimit të buxhetit në mënyrë substanciale nga OE.

Edhe më keq që AK ofertën tonë e ka eliminuar pa ASNJË BAZË ligjore dhe duke u thirr në kërkesa të DT të cilat nuk kanë ekzistuar fare, dhe kjo na jep të kuptojmë se vlerësimi i ofertës sonë nuk është bërë fare, sepse ne kemi përmbushur kërkesat e DT dhe vlerësimi është bërë duke shkelur nenin 59 të LPP-së.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92. Sa i përket ofertave të tenderuesve që ofrojnë çmim mbi vlerën e parashikuar të kontratës, Paragrafi 1 si dhe paragrafi 2.1 i neni 62 të LPP-ës përcaktojnë si në vijim:

Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

"të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit"

Me vet faktin që paragrafi i lartë cituar përmend fjalën **mund** dhe jo kushtimisht **duhet** (ta anuloj aktivitetin e prokurimit) Autoriteti Kontraktues nuk është i obliguar ta anuloj një aktivitet të prokurimit edhe pse të gjithë tenderuesit të përgjegjshëm kanë ofruar çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për atë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se çmimet e ofruara në ofertë janë çmime reale të tregut si dhe ka siguruar mjete shtesë, duke u siguruar me dëshmi me shkrim nga ZKF dhe ZKA, për këtë aktivitet të prokurimit, AK nuk është i obliguar ta anuloj aktivitetin në fjalë, por mund të vazhdojë me procedurë të mëtutjeshme.

Për këtë çështje ka Interpretim nga KRPP-ja dhe Vendim nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. 124-125/21.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

1. Arësyeja e parë pse AK na ka eliminuar është se ne nuk e kemi plotësuar DEKLARATEN NËN BETIM konform LPP-së.

Kjo arësye nuk qëndron sepse DEKLARATA NËN BETIM është nënshkruar nga personi i autorizuar ashtu siq është interpretimi i KRPP-së Nr.40 në të cilin ju jeni thirrur. Në të gjitha procedurat e prokurimit DEKLARATA NËN BETIM nënshkruhet nga BASHKIM MAZREKU sepse për këtë ekziston AUTORIZIMI i datës 23.10.2019 i NOTERIT ku ceket se: AFRIM MAZREKU e AUTORIZON BASHKIM MAZREKUN për nënshkrimin e të gjitha dokumenteve përfshirë kontratat dhe përfaqësinin e biznesit MAZREKU SHPK në të gjitha Institucionet. Ky Autorizim është para datës së dorëzimit të ofertave dhe nëse AK ka patur të pa kjoartë këtë situatë, konform NENIT 72 të LPP-së ka mundur të kërkojë sqarime siq specifikohet në LPP dhe në RRUOUPP e jo të DËMTUJË BUXHETIN siq ka vepruar me vendimin e datës 03.06.2022. Më këtë veprim AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, nenin 72 të LPP-së dhe nuk ka respektuar dispozitat tjera ligjore lidhur me këtë procedurë siq janë nenet:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që me formular: B42 Letër

Standarde për tenderuesin e eliminuar jeni informuar, duke cekur:

Ne baze të interpretimit të KRPP-së të pyetja Nr. 40 (të pyetjet e shpeshta) citat: 40. Si të veprohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent, nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi

identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi "për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.

Edhe pse në Kërkesë për rishqyrtim, pretendoni se ekziston Autorizimi i datës: 23.10.2019, por ne ofertën e juaj të dorëzuar me datë: 17.05.2022, nuk keni bashkangjitur Autorizimin Bazuar në RrUOPP – së, Neni 39, paragrafi 39.5, tregon për dokumentet që mund të kërkohen dhe që nuk kërkohen për sqarim: *Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se*

Por duke u bazuar në Interpretimin e KRPP – së ku thotë: *KRPP, konsideron se, nënshkrimi "për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.*

Për këtë çështje ka vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. PSH611-612/20.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

2.Në pikën tjetër AK thotë se ne nuk kemi paraqitur Listën e projekteve të përfunduara. Kjo nuk qëndron sepse në ofertën tonë është lista e projekteve të ngjashme të realizuara.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar

III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 7,500.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2: Lista e projekteve të kryera në lëmin e furnizimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar: Furnizimet e kryera, shumën e kontratës, vendit dhe nr. e prokurimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, e përcjellur me Kopje të Referencës përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses.

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operatorë Ekonomik, Lista e projekteve të kryera në lëmin e furnizimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë është e panënskruar dhe e pavulosur nga Operatori Ekonomik, por është në formatin Excel

Shihet tabelën e bashkangjitur:

LISTA E KONTRATAVE DHE REFERENCAVE - Excel

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J
		RRÉGULLIMI DHE RRETHIMI I VARREZAVE NË KOMUNËN E DRENASIT					gentiana.nela@rks.gov.net			
19		- FAZA E DYTE :611 20-5677-5-2-1	05.11.2020	20.12.2020	7,947.67 €	KOMUNA GLOGOC		038-200-40-811		
20		Ndërtimi i minipareqeve dhe këndeve të lojërave në territorin e Komunës së Fushë Kosovës - faza e dytë	07.12.2020	25.03.2021	9,190.00 €	KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË	bedri.lobertica@rks.gov.net	038/ 2004511; 038/ 20040512		
21		RRETHOJAT E OBORREVE TE SHKOLLAVE - FAZA E DYTE :611 20-6521-5-2-1	06.11.2020	22.12.2020	9,840.00 €	KOMUNA GLOGOC	gentiana.nela@rks.gov.net	038-200-40-811		
22		Ndërtimi i një rrethimi rreth oborrit të shkollës në Mogillë: 660-20-7015-5-2-1	09.11.2020	24.12.2020	11,911.90 €	KOMUNA E KLOKOTIT	nabavikaklokoj@gmil.com	049/859169		
23		Ndërtimi dhe rregullimi i rrethojave në shkollë dhe QKMF-re, QMF dhe AMF: VU644-21-3738-5-2-1	07.09.2021	11.12.2021	28,781.26 €	KOMUNA E VUSHTRRISE	prokurimi.vushtri@rks.gov.net	038/200-42403		
24		Furnizim me Ciment: 12997 12998-21-857 1-3-6	19.03.2021	20.12.2021	3,411.38 €	Trepça SH.A.	treprap@prokurimi@yaho.com	078/538-050		
25		FURNIZIM ME PAISJE SPORTIVE NE SHIFMU NE DRENOVC - PROJEKTI SAVE THE CHILDREN: 614-21-6071-1-3-6	05.10.2021	25.11.2021	2,690.00 €	KUVENDI KOMUNAL I KLINËS	abaz.fonolaj@rks.gov.net	038-200-41-715 049-226060		
26		Furnizim me fraksione të rëres(zallit): nuk ka-21-567 1-3-6	20.03.2021	22.12.2021	3,189.00 €	Komp. Rajon Ujësjellësit "Hidromorav" SH.A.	sametidrizi@hqlmail.com	044 194 054		
27		Rregullimi i parkingut te SHML Dardania - Hani i Elezit dhe montimi i roleteve te cerdhja: 659-21-5811-5-3-6	24.09.2021	25.10.2021	2,920.00 €	KOMUNA HANI I ELEZIT	prokurimi.he@gmail.com	038/200-46-561		
28		Furnizimi dhe montimi i ulëseve për nxënësit në oborret e shkollave: VU644-20-7888-1-3-6	20.10.2021	20.12.2021	3,780.00 €	KOMUNA E VUSHTRRISE	prokurimi.vushtri@rks.gov.net	038/200-42403		
					213,742.00 €					
		OE MAZREKU SHPK 811303784								

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

- 3.Pikat tjera në të cilat AK është thirrur që ne nuk i kemi plotësuar nuk janë fare pjesë e D'I dhe e kritereve kualifikuese.
- 3.1 AK thotë se ne nuk kemi dorëzuar deklarate me shkrim në të cilën garanton se pajisjet e ofruara do të jenë me garancion 12 muaj !!! kjo kërkesë nuk është pjesë e D'T dhe ne nuk mundë të plotësojmë diçka që nuk kërkohet me DT.
- 3.2 AK thotë se ne nuk kemi dorëzuar deklarata për specifikime teknike !!! As kjo kërkesë nuk është pjesë e DT.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që me formular: B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar jeni informuar, *duke cekur*:

Në Dosjen e tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), është kërkuar:

II.5 Vendi për dërgimin e furnizimeve është: NË ÇERDHIEN E FËMIJËVE “TULIPANËT” NË RAHOVEC

Është kërkuar:

Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë një deklaratë me shkrim të nënshkruar dhe vulosur (origjinale) me të cilën merr përgjegjësi dhe obligime se duhet të kryhet liferimi i Furnizimit Brenda afatit kohor.

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operatorë Ekonomik, nuk keni paraqitur Kërkesën e lartëcekur, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

II.4 Kërkesat e garantimit:

Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë një deklaratë me shkrim të nënshkruar dhe vulosur (origjinale) me të cilën garanton se pajisje e ofruara do të jenë me garanci 12 muaj.

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operatorë Ekonomik, nuk keni paraqitur Kërkesën e lartëcekur, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike

II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike - furnizimet ☒ duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1.

“Deklarata për Specifikimet Teknike” e dorëzuar nga OE është një dokument që garanton se me rastin e furnizimit të këtyre pajisjeve, OE ofertues respektivisht kontraktuesi i mundshëm do ti ofroj pajisjet sipas specifikimit teknik të AK-së.

Në ofertën e juaj të dorëzuar mungon Deklarata për Specifikime Teknike të Detyrueshme dhe nuk jepni asnjë dëshmi se do ti përmbushni të gjitha specifikat teknike sipas ANKESIT 1 të Dosjes së tenderit.

Sipas RrUOPP-së, Neni 39. Sqarimi i Tenderëve thotë: Mungon Deklarata për Specifikat teknike – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – Neni 28 i LPP-së.

Për këtë çështje ka vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. 495/20 & 31/20, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Te gjitha kërkesat janë kërkuar në Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD), duke cekur NENIN e FTD-së, siç është përshkruar me lartë dhe në formularin B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit;
Komuna e Rahovecit